


“Vlera të rishfaqura” si një rizbulim i qytetit

Teuta TOSKA



Libri “**Vlera të rishfaqura**” i prof.dr. Tomor Plangaricës, botuar nga shtëpia botuese “Onufri” në fund të vitit 2019 dhe që mban si nëntitull “*përmbledhje me studime, në 110-vjetorin e Shkollës Normale të Elbasanit*” është ndoshta ngjarja më e rëndësishme shkencore dhe kulturore për qytetin e Elbasanit me rastin e përvjetorit të ngjarjes së përmendur në nëntitull. Ai përmbledh në 355 faqe 27 studime rreth 2 institucioneve të rëndësishme arsimore të qytetit të Elbasanit me rëndësi mbarëkombëtare: Normalja, pra, dhe Ushtrimorja; rreth disa ngjarjeve historike lidhur me këto institucione, si Kongresi i Elbasanit, Komisia Letrare e

Shkodrës; rreth disa organeve shkencore, publicistike, letrare, si “Normalisti, në radhë të parë, gazeta “Tomorri”, “Shkumini”, “Kopshti letrar” dhe pastaj rreth shumë veprave dhe autorëve, të cilët njihen pak në nivel kombëtar, por edhe në qytetin të cilët ata i përkasin. Libri në fjalë përmbledh studime për 17 figura të rëndësishme të qytetit, që kanë kontribute të përveçme në historinë e shqiptarëve, por ndërkohë përmend dhe jep informacione për 60 emra të tjerë¹ më pak të njohur të qytetit, që i përkasin kryesisht periudhës

1 “Vlera të rishfaqura”, botim i cituar, nga faqja 41 deri 43 mund të gjenden emrat e figurave të qytetit (edhe figura që nuk janë nga Elbasani, por që lidhen me të në një farë mënyre), dhe kontributet përkatëse.

nga hapja e Normales (1909) dhe deri në periudhën e instalimit të Pushtetit Popullor. Këta artikuj përfshijnë kërkime dhe shkrime nga ana e autorit në një periudhe prej 28 vjetësh. Studimi i parë është botuar në gusht të vitit 1991 (për Ethem Haxhiademin²) dhe i fundit në këtë vit³.

Numrat që i kam përmendur më sipër kam dashur t'i përdor si njëfarë sugjestionimi për lexuesin e sotëm, për të cilin numrat dhe sasia shpesh interpretohen si cilësi e kërkimit. Në këtë rast, këta numra vërtet janë një tregues që shenjon gjerësinë e pashembullt të interesit, por edhe të realizimit të kërkimit shkencor, për institucione, ngjarje historike, personalitete dhe produktin kulturor e shkencor të këtyre institucioneve dhe personaliteteve në rrjedhë të kohës. Nuk ka ndonjë libër tjetër në të cilin të përfshihen kaq shumë, ose thuhet të gjitha figurat e rëndësishme të një qyteti në një periudhë të caktuar të tij, në periudhën më të lavdishme të historisë së vet me ndikim mbarëkombëtar. Nga ana tjetër, këto figura janë vështruar duke i analizuar me koncepte e teori të pikëpamjeve bashkëkohore në fushat shkencore që do t'i përmendim më poshtë. Kjo e bën librin një burim reference për studiuesin që kërkon të hulumtojë për figurat intelektuale të qytetit të Elbasanit, dhe më gjerë.

Përfshirja e një harku kohor kaq të gjerë (28 vjet) më tregon disa gjëra: kemi përpara projektin kërkimor të një jete (njërin prej projekteve kërkimore), i cili e ka ndjekur rrugën e formimit shkencor të prof.Plangaricës. Pra, qyteti i vet dhe produkti intelektual i qytetit. Në fakt projektet e tij shkencore kanë lëvizur në rrjedhë të kohës në terrene të pashkelura të gjuhësisë në Shqipëri. Ai ka qenë jo vetëm në Universitetin e Elbasanit, por dhe në gjithë mjedisin akademik shqiptar nismëtar i kurseve universitare edhe i studimeve të para shkencore në: sociolinguistikë, gjuhësi e zbatuar, psikolinguistikë, gjuhësi e tekstit, analizë e diskursit, gramatikë kognitive. Por profesori ka pasur guximin për të shkelur dhe hulumtuar edhe përtej gjuhësisë në fusha në kapërcyell, si: në historinë e mendimit gjuhësor, filozofinë e gjuhës, antropologji, epistemologji apo edhe në historinë e mendimit dhe filozofi. Te libri ne e shohim ndërthurjen mes këtyre dy projekteve kërkimore: nga njëra

2 Artikulli "Jo vetëm dramaturgu, por edhe poeti" (mbi krijimtarinë poetike të Ethem Haxhiademit), f.157-195 (në këtë botim), botuar në fillim në "Univers i vlerave të munguara", Sejko, 2002, por që mban në fund të artikullit shënimin "gusht 1991".

3 Artikulli "Shuarja e zërit të një komuniteti diskursiv si dramë sociale", f.100-116 (në këtë botim) dhe botuar edhe te Peizazhe të Fjalës, ISSN 2475-1375, në 15 nëntor 2019, me titullin "Shurdhimi i një komuniteti diskursiv" <https://peizazhe.com/2019/11/15/shurdhimi-i-nje-komuniteti-diskursiv/>, me nëntitull "**Kujtesa historike si mundësi e shërimit të plagëve sociale**".

anë, kërkimi në fushë të gjuhësisë, nga ana tjetër, qyteti dhe trashëgimia e tij intelektuale.

Numrat më sipër janë një tregues edhe për pasurinë intelektuale të qytetit. Pak qytete sot në Shqipëri kanë një trashëgimi që mund të gjenerojë kaq shtigje në kërkimin shkencor dhe që të mund të ketë qenë në koherencë me mendimin shkencor dhe kulturor evropian. Për disa prej fushave të gjuhësisë (që janë zhvilluar pas viteve '90 te ne) autori ka pretendimin se i ka gjetur fillesat (në historinë e shkencës shqiptare) në veprimtarinë e figurave /institucioneve që ka studiuar të këtij qyteti. Për të konfirmuar këto pretendime, profesori ka parashtruar njohuri të gjera në historinë, metodologjinë dhe këndvështrimin e këtyre disiplinave të reja, si: sociolinguistikë, psikolinguistike, politike gjuhësore, gjuhësi teksti, tekstologji etj.

Fjala më e rëndësishme e librit sipas meje, është “*mjedisi*”, apo më mirë “*mjedisi intelektual*”. Kjo fjalë është ai filli që bashkon të gjithë artikujt, por është edhe si ajo fjala-kyç që zgjidh gjithë enigmën e lojës. Kjo fjalë është përgjigja e dy pyetjeve që i ndiej ndërsa lexoj artikujt dhe që, sipas meje, i ka pasur në mendje studiuesi: pse dhe si. **PSE** Normalja dhe figurat e lidhura me të ishin kaq të suksesshëm, kaq shoqëririndryshues, kaq bashkëkohorë në dije e kulturë? **SI** ndodhi që pikërisht në këtë qytet?

Dhe, përgjigja është “*mjedisi*”. Jo një njeri, por një grup njerëzish, një qëndrim shpirtëror dhe mendor, dhe dëshirë që e përshkoi tejetet qytetin. Këto pyetje janë artikulum i “shqetësimit” intelektual dhe i paretatisë dhe padurimit të studiuesit deri në kërkim të përgjigjes/përgjigjeve të vërteta.

Këto pyetje dhe ndërthurja që përmendëm më sipër kushtëzojnë kërkimin dhe natyrën e librit: Edhe pse ngjarjet, institucionet, personalitetet, dukuritë, tekstet në analizë në këtë libër janë objekt historik, i përkasin së kaluarës (Normalja, Ushtrimorja, Kongresi i Elbasanit, revista “Normalisti”, K.Kristoforidhi, Lef Nosi, Ethem Haxhiademi, Emin Matraxhiu, Thanas Floqi, Simon Shuteriqi, Vasil Andoni, Ali e Mahmud Cungu, A.Xhuvani dhe K.Cipo, Aleks Buda, Hyjni Ceka, Bim Dakli - për të përmendur figura që tashmë i përkasin historisë së qytetit dhe objekte shkencore në këtë libër), nuk kemi këtu historiografi – nuk bëhet përshkrim i fakteve historike, të panjohura ose të pazbulura e të studiara si duhet. Në fakt, studimi historik është një instrument anësor në këtë kërkim/libër. Thelbi është “filozofik”, pra hetimi i shkaqeve dhe mënyrave - si dhe pse është prodhuar një kulturë, institucion, ngjarje madhore, personalitet. Dhe si në një qasje të tillë filozofike, kjo “pse” gjeneron “pse” të tjera, që shkojnë në zbërthimin fenomenologjik të së vërtetës.

Kështu që e gjithë kjo e kushtëzon edhe llojin e lexuesit të këtij libri: ky nuk mund të shkojë tek historiani, aq më tepër te historiani i sotëm shqiptar, në një pjesë të madhe ende i paçliruar nga mitologjitë kombëtariste. Studenti dhe studiuesi i historisë do ta ketë të vështirë për ta rrokur gjithë kuptimësinë e tekstit. Lexuesi i këtij teksti duhet të jetë studiuesi i kulturës, mendimit, filozofisë, me një bagazh të mirë në letërsi dhe gjuhësi, dhe që ka të mprehur edhe shqisën historike dhe kronologjinë e ngjarjeve madhore historike të Shqipërisë dhe të qytetit të Elbasanit. Po ashtu, ky libër kuptohet fare mirë edhe nga ata që janë të përfshirë me studime për historinë e mendimit pedagogjik, gjuhësor, por edhe me historinë e mendimit politik; kemi të përfshirë dhe cituar në këtë libër edhe autorë që shtjellojnë pikëpamje shkencore në teorinë e kulturës, teorinë e mitit, në epistemologji dhe filozofi.

Së fundi, desha të bëj pyetjen më të rëndësishme të një pune shkencore dhe intelektuale: *ç'vlerë ka ky libër?*

Përtej vlerës që ka një libër për studiuesin, kërkuesin, projektin e ardhshëm shkencor, desha të artikuloj çfarë mendova pasi e përmbylla leximin e librit: Nëse do ta kishim një tekst të tillë përpara dy vitesh, konferenca që iu kushtua figurave të rëndësishme të albanologjisë së qytetit⁴ do të kish pasur një program edhe më të gjerë dhe një konceptim tjetër. Por, ky libër na bëhet i domosdoshëm për programin dhe konceptimin e një konference tjetër të ngjashme pas disa vitesh. Qyteti paska ende për të zbuluar!

Ky libër nxit një ridimensionim të konceptit për trashëgiminë intelektuale të qytetit në qytet. Përtej interesit se si mendimi shkencor botëror mund të analizojë dhe vlerësojë a kritikojë prodhimin tonë kulturor, shkencor, ky libër na nevojitet për të rikonceptuar universitetin në Elbasan, por edhe në Shqipëri, në një kohë kur dija që mendojmë se e japim në universitet dhe produkti shkencor aty ka aq pak ndikim në jetën shoqërore të vendit.

Edhe, ashtu siç është dëshira e çdo studiuesi, këto studime kanë si synim (citoj profesorin në parathënien e librit) *“përçimin e mesazhit jo vetëm në funksion informues, por edhe ndikues”*⁵, sigurisht, në radhë të parë, për të ndikuar tek qyteti dhe universiteti, që ta rivlerësojë këtë trashëgiminë e vet, dhe çfarë më e rëndësishmja, të ndryshojë prej saj të tashmen e vet.

4 Po flas për konferencën shkencore “Punëtorë të shquar të albanologjisë”, mbajtur në 13 mars 2019, organizuar nga Universiteti i Elbasanit, departamenti i gjuhësisë, dhe Akademia e Studimeve Albanologjike, për nder të figurave të njohura, por edhe jo aq të njohura të qytetit, që kanë punuar në lëmë të albanologjisë. Aktet e kësaj konference janë botuar në dhjetor 2019, “Shpresa print”, ISBN 978-9928-4559-9-4

5 “Vlera të rishfaqura”, botim i cituar, f.XVII.